

# **BULETINI METROLOGJIK**

NR.1 - 2023

## **Përmbajtja:**

1. Lëvizja e lirë e mallrave
2. Trajnim – Njohja me kërkesat e standardit ISO/IEC 17020:2012 dhe implementimi i tyre në Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë
3. Fushata ndërgjegjësuese për metrologjinë në qytetin e Vlorës
4. Informacion rreth aktivitetit të DML për vitin 2022
5. Shkëmbime eksperience me universitete dhe institucione
6. Miratim i akteve nënligjore
7. Vendimet për autorizim

## **BULETINI METROLOGJIK**

---

### **Pasqyra e lëndës:**

1. "Lëvizja e lirë e mallrave", Shqipëri -BE.....	3
2. Trajnimi "Njohje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17020:2012 dhe implementimi i tyre në Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në DPM" .....	4
3. Fushata ndërgjegjësuëse dhe promovuese për metrologjinë në qytetin e Vlorës.....	4
4. Informacion i përgjithshëm rreth aktivitetit të Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore (DML), për vitin 2022. ....	5
5. Shkëmbim eksperience e stafit të DPM-së me universitete dhe institucione.....	8
6. Miratimi i akteve nënligjore .....	8
7. Vendimet për autorizim:.....	8

## **1. "Lëvizja e lirë e mallrave", Shqipëri -BE, rregulla të harmonizuara për shkëmbimet tregtare**

**Zj. Erinda Piluri**  
**Zv. Drejtor i Përgjithshëm**

Takimi Bilateral Screening mes Bashkimit European dhe Shqipërisë për kapitullin 1 "Lëvizja e lirë e mallrave", u zhvillua nga 30 janar-2 shkurt në Bruksel.

Lëvizja e lirë e mallrave është një nga katër liritë themelore të Bashkimit European. Parimi i lëvizjes së lirë të mallrave nënkupton që produktet duhet të qarkullojnë lirshëm nga një pjesë e Bashkimit në tjetrën.

Grupi i ekspertëve të MFE dhe institucioneve të tjera që janë të përfshirë në këtë kapitull bënë prezantimet përkatëse se çfarë është arritur deri tani për to.

Gjatë këtij takimi u theksua se Oeveria shqiptare do të marrë nisma për heqjen e masave kufizuese në importin e mallrave dhe lehtësimin e tregtisë. Këto masa do ta bëjnë vendin tonë më të hapur kundrejt tregjeve europiane.

Për të mundur lëvizjen e lirë të mallrave, acquis në këtë kapitull parashikon një kuadër rregullator të harmonizuar sipas "qasjes së vjetër" (duke parashikuar specifikime të detajuara për produktet) ose sipas "qasjes së re" (duke vendosur kërkesa të përgjithshme për produktet) në disa sektorë.



**Figura 1.**  
*Prezantimi i direktivave të DPM-së*

Legjislacioni i harmonizuar european mbi produktet, i cili duhet të transpozohet, përfaqëson pjesën më të madhe të acquis. Për më tepër, është thelbësore të ekzistojnë kapacitete të mjaftueshme administrative për të njoftuar kufizimet në tregti dhe për të zbatuar masat horizontale dhe procedurale në fusha të tilla si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

Shqipëria tashmë ka hyrë në një proces të rëndësishëm, pas hapjes së negociatave drejt anëtarësimit në Bashkimin European. Nga 33 kapituj gjithsej në procesin e Integritimit European, Ministria e Financave dhe Ekonomisë drejton 13 kapituj dhe 2 kapituj me bashkënegocim, si dhe Kriterin Ekonomik.




**Figura 2.**  
*Momente gjatë takimit*

## **2. Trajnimi "Njohje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17020:2012 dhe implementimi i tyre në Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në DPM".**

**Zj. Majlinda Senka**  
**Përgjegjëse e Sektorit të Sigurimit të Cilësisë**

Në kuadër të zbatimit të planit të masave për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në metrologjinë ligjore, gjatë katër mujorit të fundit të vitit 2022, në ambientet e sektorëve të shërbimit, nga Sektori i Sigurimit të Cilësisë të Drejtorisë të Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) u organizua trajnimi mbi Standardin SSH ISO/IEC 17020:2012 "Vlerësim i konformitetit - Kërkesat për funksionimin e llojeve të ndryshme të organizmave që kryejnë inspektim" për punonjësit e Sektorëve të Shërbimeve të Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore.



**Figura. 3**  
*Prezantim i kërkesave të standartit*

Si fillim, trajnimi u ofrua për punonjësit e Sektorit të Shërbimit nr. 2, Fier, i cili u pasua edhe në sektorët e shërbimit Lezhë dhe Korçë.

Gjatë trajnimit, përveç prezantimit të kërkesave teknike të standardit ISO/IEC 17020:2012, u diskutuan edhe çështje konkrete që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme gjatë rasteve praktike të shërbimeve verifikuese. Në fund të trajnimit, pjesëmarrësit morën certifikatë trajnimi.

## **3. Fushata ndërgjegjësuere dhe promovuese për metrologjinë në qytetin e Vlorës.**

**Z. Dritan Jano**  
**Përgjegjës sektori**

Në muajin janar 2023 në qytetin e Vlorës u zhvillua një aktivitet ndërgjegjësues dhe promovues mbi rolin dhe rëndësinë e infrastrukturës të cilësisë. Ky aktivitet u realizua në kuadër të aktiviteteve promovuese të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ku përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), morën pjesë në aktivitet së bashku me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS).



**Figura. 4**  
*Vizitë në universitetin "Ismail Qemali", Vlorë*

Me studentët dhe pedagogët e universitetit "Ismail Qemali" u diskutua roli dhe rëndësia e metrologjisë, si dhe shërbimet e ofruara prej saj në kuadër të aktiviteteve dhe punëve shkencore të realizuara prej tyre.

Përfaqësuesit e institucioneve të infrastrukturës të cilësisë zhvilluan takim në ambientet e Dhomës të Tregtisë dhe Industrisë, Vlorë, ku DPM diskutoi me përfaqësuesit e bizneseve të qyteteve, shërbimet e kalibrimit, kërkesat ligjore të instrumenteve matëse dhe metodat e matjes në sektorët e tregtisë për të siguruar mbrojtjen e konsumatorit.



**Figura. 5**


*Vizitë në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë,  
Vlorë*

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë do të vazhdojë fushatat ndërgjegjësuese edhe në qytete të tjera të Shqipërisë.

#### **4. Informacion i përgjithshëm rreth aktivitetit të Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore (DML), për vitin 2022.**

##### **Zj. Enera Malaj Specialiste e Metrologjisë Ligjore**

Drejtoria e Metrologjisë Ligjore, ka përmbushur misionin e saj për mbrojtjen e konsumatorëve dhe të shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve të instrumenteve matëse, nëpërmjet kontrollit metrologjik ligjor të instrumenteve matës duke realizuar gjatë vitit 2022 verifikimin e 36 668 instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, në përdorim nga 20 453 subjekte. Si rezultat i ketyre shërbimeve të ofruara janë grumbulluar 54 988 699 leke të ardhura (pa TVSH), me realizim 113.4%.



**Figura nr.6:**

*Momente gjatë procesit të verifikimit të instrumenteve matëse (majtas - peshore automobilistike, djathtas – kontaliter)*

Keto shërbime janë ofruar nga 4 (katër) Sektorët e Shërbimit të saj, konkretisht: nr.1, Tiranë, nr.2, Fier, nr.3, Lezhë dhe nr.4, Korçë, duke mbuluar në këtë mënyrë me shërbimin metrologjik të verifikimit të instrumenteve matëse, gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.



**Figura nr.7**

*Momente të procesit të verifikimit të instrumentit matës peshore elektronike*


Gjatë vitit 2022, janë realizuar verifikime të ndryshme të instrumenteve matëse të cilat janë listuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Tipi i Instrumenteve	Nr. i instrumenteve të verifikuara
1.	Masa volumore	14707
2.	Gramarë	4139
3.	Peshore (NAWI)	10191
4.	Peshore automobilistike	238
5.	Dozatorë	4013
6.	Taksimetra	2187
7.	Rezervuarë	424
8.	Kontalitra	392
9.	Metra	377
<b>TOTALI</b>		<b>36668</b>

**Tabela nr.1**

*Instrumentet e verifikuar gjatë vitit 2022.*


Gjithashtu, në mënyrë grafike paraqesim edhe shpërndarjen që ka secili tip instrumenti matës ligjërish i kontrolluar, krahasuar me numrin e përgjithshëm të instrumenteve të verifikuar.



**Grafiku nr.1**

*Shpërndarja që ka secili tip instrumenti, referuar numrit total të instrumenteve të verifikuar, gjatë vitit 2022*

Referuar ligjit për metrologjinë nr.126/2020, Drejtoria e Metrologjisë Ligjore, gjithashtu ndjek procedurat për autorizim të shërbimeve të cilat nuk mund të realizohen prej saj. Për vitin 2022, nga strukturat e DPM-së janë trajtuar gjashtë kërkesa për autorizim dhe janë miratuar gjashtë vendime administrative, nga të cilët dy janë riautorizime, tre autorizime për herë të parë dhe një ndryshim autorizimi. Në mënyrë grafike të dhënat mbi autorizimet e dhëna gjatë vitit 2022, paraqiten më poshtë.



**Grafiku nr.2**

*Paraqitje grafike e shpërndarjes së autorizimeve të dhëna, gjatë vitit 2022.*

Nga gjashtë vendimet administrative (autorizime) të dhëna, dy janë për verifikim të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, matësa uji, tre për riparim të instrumenteve matës, shpërndarës karburanti dhe një ndryshim autorizim për verifikim të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, matës të energjisë elektrik.

Gjatë vitit 2022 janë kryer 14 (katërmëdhjetë) vizita monitoruese në subjektet e autorizuara nga DPM-ja dhe janë trajtuar 49 (dyzet e nëntë) raportime aktivitetesh të këtyre subjekteve.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale (DMSHI) është realizuar kalibrimi i gjithë instrumenteve matës (etaloneve të punës) të fushës së volumeve dhe masës, që përdoren nga specialistët e Sektorëve të Shërbimeve, për kryerjen e procesit të verifikimit të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar. Janë kalibruar peshoret elektronike, gramarë të kapaciteteve dhe klasave të ndryshme dhe cilindra qelqi. Për çdo instrument të kalibruar janë lëshuar certifikatat e kalibrimit, nga Sektorët përkatës të DMSHI-së.

Gjatë vitit 2022, Drejtoria e Metrologjisë Ligjore ka patur bashkëpunime të vazhdueshme me Bashkinë Tiranë e Durrës, për numrin e licensave të dhëna për ushtrim aktiviteti transport

udhëtarësh, shërbim taksi. Nuk ka munguar komunikimi edhe me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) për të dhënat mbi subjektet dhe instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara, që verifikohen nga DPM-ja, subjektet që paketojnë parapaketime dhe disponojnë instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara. Në këto komunikime janë trajtuar problematikat e terrenit, për subjektet që nuk pranojnë dhe/ose pengojnë kryerjen e verifikimit të instrumenteve matëse që kanë në përdorim;

Për përmirësimin e njohurive dhe zhvillimin profesional të stafit të DML janë miratuar programe trajnimi, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPM, nr. 149, datë 06.04.2022 "Për organizimin e trajnimeve të nevojshme për zhvillimin e aftësive profesionale për specialistët (metrolog të autorizuar) të sektorëve të shërbimeve të DML-së", si dhe urdhëri nr.152, datë 08.04.2022 "Për miratimin e programit të trajnimit për punonjësit e rinj të DML-së".

Përsa më sipër, janë organizuar trajnime në:

- fushën e parapaketimeve për punonjësit që ofrojnë këtë shërbim në katër Sektorët e Shërbimeve të DML-së.
- fushën e masës, si dhe
- njohuri të përgjithshme rreth standartit ISO/IEC 17020:2012.

## 5. Shkëmbim eksperience e stafit të DPM-së me universitete dhe institucione.

### Zj. Qëndrime Bregu Drejtoreshë e Drejtorisë të Burimeve Njerëzore dhe Mbështetëse

Në kuadër të bashkëpunimit institucional në datë 03 nëntor 2022, në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) u zhvillua një vizitë nga përfaqësues të Forcave Ajrore Shqiptare dhe përfaqësues të Ekipit të Aviacionit Amerikan.

Fokusi i vizitës konsistoi në njohjen nga afër të instrumenteve matës, laboratorëve të Metrologjisë Shkencore dhe Industriale dhe shërbimeve të kalibrimit të ofruara nga DPM.

Pjesëmarrësit krijuan ide të qarta mbi kapacitetet kalibruese të cilat ofron vendi ynë në funksion të bashkëpunimit që Ministria e Mbrojtjes Shqiptare ka me qeverinë amerikane nëpërmjet Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes të Ambasadës Amerikane.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë në këtë takim shprehu mbështetjen e saj për vazhdimësinë e bashkëpunimit në të ardhmen nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe trajnimeve në fushat e kërkuara.



**Figura 8.**

*Vizitë në laboratorin e temperaturës të përfaqësuesve nga forcat e armatosura ajrore.*

Gjate muajit janar të këtij viti, specialistët e DPM-së patën mundësinë t'iu shpjegojnë dhe tregojnë studentëve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, dega inxhinieri ambientet e laboratorëve dhe procedurat e punës për secilin shërbim kalibrimi. Studentëve iu ofrua mundësia e realizimit të matjeve kalibruese në fusha të ndryshme në kuadër të zhvillimit të diplomave dhe proceseve mësimore.



**Figura 9.**

*Vizitë në laboratorin elektrik të studentëve të universitetit "Ismail Qemali"*

## 6. Miratimi i akteve nënligjore

Urdhëri nr.219, datë 21.09.2022 "Për miratimin e rregullores për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara".

## 7. Vendimet për autorizim:

- "FERALB" SHPK, me nr. NIPT-i K04005025F, me adresë Lagjja nr.1, rruga "Telemak Germenji", Korçë, autorizuar sipas Vendimit administrativ Nr.5, datë 03.10.2022 "Për riparim, verifikim dhe vulosje të instrumenteve



matëse ligjërisht të kontrolluara, shpërndarësve të karburantit". Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 03.10.2022, ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 02.10.2026;

- **"MISCOM" SHPK**, me nr. NIPT-i L61830014C, me adresë rruga "Selitë e vjetër", pallati "Syri i Liqenit", Tiranë, autorizuar sipas Vendimit administrativ Nr.6, datë 01.11.2022 "Për riparim, verifikim dhe vulosje të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, shpërndarësve të karburantit". Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 01.11.2022, ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 31.10.2026;

- **"ECIT" SHPK**, me nr. NIPT-i L02904408M, me adresë rruga "Medar Shtylla", ndërtesa Nr.30, Tiranë, autorizuar sipas Vendimit administrativ Nr.1, datë 14.02.2023 "Për verifikim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, cisterna rrugore (autobote)". Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 01.03.2022 ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 28.02.2026.

## **KËSHILLI BOTUES**

**Erinda Piluri, Majlinda Senka,  
Stilian Habibi, Dëfrim Bulku,  
Xhensila Ibrahim**

### **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË**

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km.8,  
Kashar, Tiranë, SHQIPËRI  
E-mail: metrology@dpm.gov.al  
Web: www.dpm.gov.al